

15 tetor 2025,
Prishtinë

Komisioni i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e mbajtur me datë 15.10.2025, në përbërje prej: Armend Hamiti kryetar i KG, Arianit Shala anëtar i KG dhe Ismet Ferati anëtar i KG shqyrtoi dhe miratoi këtë:

VENDIM NR. 05/2025-26 I KOMISIONIT TË GARAVE

I. Komisioni i Garave, bazuar në informacionet e siguruar nga mediat, si dhe në vlerësimin e Instruktorit Nacional të FBK-së lidhur me xhiron e parë të ProCredit Superligës së Meshkujve, ndeshja KB Bora – KB Rahoveci, konstaton shkelje të rregullave zyrtare të lojës. Konkretisht, bëhet fjalë për praninë e gjashtë (6) lojtarëve të KB Bora në parket – situatë e cila nuk është identifikuar dhe trajtuar në mënyrë të duhur nga treshja e gjyqtarëve dhe vëzhguesi i ndeshjes.

II. Komisioni i Garave vlerëson se provat e ofruara janë të mjaftueshme për shqyrtimin e këtij rasti, dhe në përputhje me kompetencat e parashikuara në nenin 41.16 të Propozicioneve të Garave, vendos të analizojë gabimet e bëra nga gjyqtarët dhe vëzhguesi i ndeshjes. Prania e gjashtë lojtarëve në fushë nuk është vërejtur nga treshja e gjyqtarëve, as nga vëzhguesi i ndeshjes.

III. Pas shqyrtimit të informacionit medial, provave materiale (videoincizimit të ndeshjes), si dhe vlerësimit të paraqitur nga Instruktori Nacional i FBK-së, dhe në përputhje me nenin 53.1 të Propozicioneve të Garave, Komisioni i Garave vendos që treshja e gjyqtarëve:

- Amar Djeković
- Dren Pudarolli
- Ardi Haxhijadini

si dhe vëzhguesi i ndeshjes:

- Hajradin Zeka

ndëshkohen me mos delegim në dy (2) ndeshje të radhës në ProCredit Superligën e Meshkujve.

IV. Ky vendim hyn në fuqi nga data e publikimit.

ARSYETIM

Gjatë vendimmarrjes lidhur Vendimin Nr. 05/2025-26, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

- (a) Video-incizimi i ndeshjes KB Bora vs KB Rahoveci 029, e zhvilluar në kuadër të xhiros së parë të ProCredit Superligës së Kosovës, është analizuar nga Instruktori Nacional i FBK-së në kuadër të vlerësimit të performancës së personave zyrtarë të përfshirë në këtë ndeshje.
- (b) Komisioni i Garave ka konstatuar se gjatë ndeshjes ka pasur shkelje të rregullave zyrtare të lojës, konkretisht praninë e gjashtë (6) lojtarëve të KB Bora në parket – një situatë që nuk është identifikuar dhe trajtuar në mënyrë të duhur nga gjyqtarët dhe vëzhguesi i ndeshjes. Këto mangësi kanë rezultuar në kryerje të papërgjegjshme të detyrës, si dhe në moszbatim të rregullave zyrtare të lojës dhe të Propozicioneve të Garave.
- (c) Andaj, siç u cek në dispozitiv të Vendimit, treshja e gjyqtarëve — Amar Djeković, Dren Pudarolli, Ardi Haxhiajdini — si dhe vëzhguesi i ndeshjes, Hajradin Zeka, ndëshkohen me mos delegim për dy (2) ndeshje të radhës në ProCredit Superligën e Meshkujve.

Në emër të Komisionit të Garave të FBK-së,

Armend **HAMITI**

Kryetar i Komisionit



Federata e Basketbollit të Kosovës



KËSHILLË JURIDIKE: Në pajtim me Nenin 45 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2025/2026, në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa tek Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së (si organ i shkallës së dytë), e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.